



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 14/2024 regjistër (JR)
Datë 12.04.2024

Nr. 25 i vendimit
Datë 05.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 05.03.2026, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 737, datë 13.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 46 e vijuese të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti ka përfutur të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave*.
 - 2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, sipas parashikimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, ka dërguar pranë Komisionit raportin², ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Majlinda Tosku.
 - 2.3. KLGj-ja, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku.³
3. Komisioni, pasi kreu hetimin e plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në konstatimet në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në një interpretim strikt të alternativave të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur sa vijon:

¹ Raporti i ILDKPKI-së me shkresën nr. {***} prot., datë 10.04.2018.

² Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 15.02.2022, të KDZH-së.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. {***} prot., datë 27.02.2023.

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] në përfundim të procesit, gjatë vlerësimit të së vetmes deklarata të subjektit, asaj vetting, u konstatua se subjekti:

a. Sipas shkronjës “a” ka kryer deklarime të pasakta dhe që bien në kundërshtim me ligjin, pasi: (i) nuk ka deklaruar përdorimin dhe posedimin e pasurisë nr. {***}, për të cilën, për shkak të rrethanave të konstatuara në lidhje me këtë pasuri mbi të cilën është sjellë si pronare, është vlerësuar se ka fshehur përdorimin e pasurisë; (ii) nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara në rrugë bankare nga dhënia me qira e kësaj pasurie, si dhe nuk ka kryer asnjë deklarim në lidhje me faktin se këto të ardhura nuk i takojnë asaj, por nënës së saj, sikurse ka pretenduar gjatë procesit të rivlerësimit.

b. Sipas shkronjës “b”, nuk justifikon tërësisht me të ardhura të ligjshme likuiditetin në cash prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklarata vetting. [...] Megjithatë, sa i takon pamundësisë financiare për të krijuar likuiditetin në cash prej 600.000 lekësh, si rrethanë më vete ky fakt nuk përbën shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në raport me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu vlerësohet se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në posedim/përdorim, që sipas pikës 5, të nenit Dh, të Aneksit të Kushtetutës përbën shkak që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, referuar edhe qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në vendimin 22, datë 16.09.2019⁴ [...] bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit pasuror [...], me veprimet dhe mosveprimet e saj, subjekti ka dështuar të provojë se është një figurë e besuar për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, që e vë atë në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. [...]

a. Në lidhje me kreditë e marra nga fondi “Besa” [...] – subjekti, në mënyrë të përsëritur, ka marrë kredi për investime në aktivitete private, të cilat nuk rezultojnë të jenë ushtruar prej saj apo familjarëve të saj; – ka kryer në mënyrë të përsëritur deklarime të rreme në formularët e marrjes së kredive; – nuk vërtetohet destinacioni i përdorimit të shumave të përfituara nga kreditë dhe nëpërmjet deklarimeve kontradiktore, e që bien në kundërshtim me fakte dhe rrethana të vërtetuara gjatë hetimit administrativ. Subjekti, në mënyrë të përsëritur, ka ndryshuar destinacionin e përdorimit të tyre; – nuk vërtetohen deklarimet e subjektit, se shlyerja e disa kredive është me të ardhurat e vëllezërve të saj. [...]

b. Në lidhje me aktivitetin person fizik – avokate [...] znj. Majlinda Tosku nuk ka bërë asnjë përçapje për çregjistrimin e ushtrimit të tij pas kërkesës që vetë ka paraqitur në QKB, në vitin 2009, përkundrazi, e ka përdorur në mënyrë të përsëritur, me qëllim marrjen e disa kredive të biznesit, destinacioni i të cilave mbeti i paprovuar sipas parashikimit në kontratat përkatëse të kredive, nëpërmjet veprimeve, të cilat konsiderohet të jenë kryer në mashtrim të ligjit.

c. Sa i takon kontratës së premtim-shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.05.2011, të lidhur me nënën e saj, D. T., u vërtetua se është lidhur në mënyrë fiktive vetëm për efekt të lidhjes së kontratës për kredi afatgjatë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.05.2011, destinacioni i së cilës mbeti i paprovuar. [...]

⁴ Shih paragrafin 67 të vendimit.

ç. Në një vlerësim tërësor të të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit u konstatua se: (i) subjekti nuk është koherente me deklaratime të mëparshme të saj dhe as me fakte të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, duke i ndryshuar ato vazhdimisht; (ii) në mënyrë të përsëritur i është shmangur dhënies së përgjigjeve në lidhje me disa nga konstatimet e Komisionit; (iii) në çdo rast i është shmangur kryerjes së veprimeve nëpërmjet llogarive bankare, në të cilat gjen pasqyrim vetëm disbursimi i shumave të përfituara nga kreditë dhe, për më tepër, të gjitha shlyerjet e kredive janë bërë në formë cash prej saj.

3.1.1. Në këto kushte, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në mënyrë të përsëritur e vijuese, duke bërë që të ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit dhe në sjelljen e saj gjatë procesit të rivlerësimit ndodhet edhe në rrethanat e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, rrethana të cilat e çojnë subjektin në përcaktimet edhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku ka arritur një nivel të besueshëm, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “e aftë”, profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

4. Në përfundim, Komisioni, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, si dhe në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 737, datë 13.02.2024, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku, ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

5. Kundër vendimit të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku, nëpërmjet të cilit kërkon: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 737, datë 13.02.2024, si dhe (iii) konfirmimin e saj në detyrë, duke pretenduar se:

5.1. Vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, i paqartë dhe i përgjithshëm, pasi nuk përmban analizë të plotë të fakteve dhe provave, në kundërshtim me standardin kushtetues të detyrueshëm për arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, sipas subjektit, ky vendim paraqitet i paragjykuar dhe i paracaktuar, në kundërshtim flagrant me detyrimin ligjor për nxjerrjen e një vendimi objektiv, të bazuar në rrethanat faktike të evidentuara dhe të provuara gjatë hetimit administrativ, si dhe vihet re mungesa e humanizmit, si një nga parimet bazë të çdo procesi.

5.2. Shkarkimi i subjektit nga detyra është kryer nga Komisioni bazuar në një arsyetim të përgjithshëm dhe sipërfaqësor, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese ligjore dhe me frymën e reformës në drejtësi. Nëse do të ishte kryer një proces i rregullt ligjor në zbatim të parimit të objektivitetit, Komisioni do të arrinte në përfundimin se subjekti duhej të konfirmohej në detyrë.

5.3. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, vetë shumica e trupit gjykues ka pranuar se ka qenë në pamundësi objektive dhe ligjore për të vlerësuar në lidhje me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, ndërsa, në anën tjetër, ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit pikërisht për këtë kriter. Për më tepër, Komisioni e ka zgjidhur çështjen duke iu referuar për analogji vendimmarrjes së arritur nga Kolegji në çështjen ndaj subjektit të rivlerësimit A. Y. Sipas subjektit, teoria juridike e pranon analogjinë vetëm në rastet e “ometimit ligjor”, kur mungon një rregull i posaçëm për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe vetëm në raport me një normë juridike, që rregullon një rast të ngjashëm, por jo në raport me zbatimin analog të vendimmarrjes që i përket një subjekti tjetër.

5.4. Subjekti i rivlerësimit thekson se nuk ka qenë më parë subjekt i deklaramit të pasurisë dhe se deklaramin e parë e ka kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit, në vitin 2017, ndërsa vlerësimi i bërë nga Komisioni i referohet një periudhe përpara ushtrimit të funksionit si ndihmëse ligjore. Konkluzioni i Komisionit për cenimin e besimit të publikut është i pabazuar, në kushtet kur subjekti, në cilësinë e ndihmëses ligjore, nuk ushtron funksion vendimmarrës dhe nuk ekziston asnjë provë apo indicie që ajo të ketë cenuar figurën dhe profesionalizmin e saj. Në kushtet kur vetë Komisioni pranon se ajo nuk është magjistrate dhe se cenimi i etikës kërkon një analizë të gjerë të faktorëve mbështetës, vendimi për shkarkimin nga detyra i subjektit mbështetet në një term abstrakt dhe, sipas subjektit, është joproporcional.

5.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshton arsyetimin e Komisionit lidhur me konstatimet për “fiktivitet” dhe veprime të kryera “në mashtrim të ligjit”, duke pretenduar se këto përfundime janë të pambështetura në prova dhe se, në mungesë të një kallëzimi penal sipas nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale,⁵ referimi i Komisionit ndaj këtyre termave mbetet i paqëndrueshëm dhe i pambështetur ligjërisht.

5.6. Lidhur me kriterin pasuror, subjekti kundërshton konkluzionin për balancën negative prej 600.000 lekësh, duke pretenduar se kjo balancë, edhe nëse merret e mirëqenë, nuk përbën shkak proporcional për shkarkim dhe nuk duhet të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor. Ajo pretendon se është penalizuar në mënyrë joproporcionale për një balancë negative prej 600.000 lekësh dhe për disa konfuzione të pretenduara në marrëdhëniet familjare, pa asnjë pasojë financiare apo juridike konkrete, duke iu referuar edhe jurisprudencës së mëparshme të organeve të rivlerësimit, si dhe në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNJ”), në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”.

5.7. Në lidhje me aktivitetin si person fizik – avokate, subjekti kundërshton arsyetimin e Komisionit, duke pretenduar se nuk është anëtare e Dhomës së Avokatisë e Republikës së Shqipërisë dhe, për rrjedhojë, nuk ka ushtruar asnjëherë profesionin e avokatit. Gjithashtu, ajo pretendon se ka provuar me dokumentacion shkresor se ka kërkuar çregjistrimin e këtij aktiviteti pranë organeve kompetente, që në vitin 2009, ndaj konkluzioni i Komisionit për “mungesë përçapjeje”, për çregjistrimin e tij është i pabazuar.

5.8. Subjekti i rivlerësimit, për sa argumentuar në shkaqet e ankimit, pretendon se Komisioni ka vendosur shkarkimin e saj nga detyra pa një analizë financiare të mirëfilltë, pa bazë të mjaftueshme ligjore dhe pa vlerësuar provat e paraqitura prej saj, ndaj në referim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për

⁵ Neni 281, “Kallëzimi nga nëpunësit publikë”.

organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Sipas subjektit, debati gjyqësor do të evidentojë se vendimi është subjektiv, në mungesë të argumenteve ligjore, i pambështetur në fakte e prova dhe në kundërshtim me ligjin.

6. Subjekti i rivlerësimit, në përputhje me nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, paraqiti në Kolegj parashtrime me shkrim, duke kërkuar përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimitimi i ankuesit

8. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

9. Shqyrtimi i çështjes në Kolegj zhvillohet në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, dhe në rastin e ankimit të vendimit të Komisionit nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi, mbi bazën e akteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt shqyrtimi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
10. Në fillim të seancës gjyqësore, trupi gjykues mori në analizë shkaqet procedurale të ankimit, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale, në kuadër të procesit të rregullt ligjor të kryer në Komision apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë

dhe të drejtë të gjendjes faktike, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të legjitimonin shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

10.1. Lidhur me shkakun ankimor, se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, i paqartë dhe i përgjithshëm, pasi nuk përmban analizë të plotë të fakteve dhe provave, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron. Nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore të Komisionit dhe vendimit të Komisionit, rezulton se ky i fundit ka kryer një hetim administrativ të plotë, ka analizuar të gjitha aktet e administruara, rrethanat faktike të evidentuara dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke arritur në një përfundim të arsyetuar mbi bazën e provave të administruara. Vetë fakti që subjekti nuk pajtohet me konkluzionet e arritura nga Komisioni nuk është, në vetvete, shkak i mjaftueshëm për të konkluduar se vendimi është i paarsyetuar ose i nxjerrë në kundërshtim me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve. Në të njëjtën linjë mbetet në nivel deklarativ dhe pretendimi i subjektit, se vendimi paraqitet i paragjykuar dhe i paracaktuar, për sa kohë nuk shoqërohet me asnjë element konkret faktik apo provë, që të evidentojë cenimin e paanshmërisë së organit vendimmarrës ose shmangien nga detyrimi për një vlerësim objektiv të rrethanave të çështjes. Sa i përket pretendimit të subjektit për “mungesën e humanizmit”, trupi gjykues çmon se ky argument, i ngritur në mënyrë të përgjithshme dhe pa referim konkret, nuk përbën një shkak juridik të pavarur, që cenon vlefshmërinë e vendimit. Ligjshmëria e vendimmarrjes vlerësohet në raport me respektimin e garancive të procesit të rregullt ligjor, të cilat, në rastin konkret, nuk rezultojnë të jenë cenuar.

Në përfundim, ky shkak ankimi vlerësohet i pabazuar, pasi argumentet e subjektit shprehin kryesisht mospajtimin me vlerësimin dhe konkluzionet e Komisionit, pa evidentuar shkelje konkrete të normave procedurale apo mungesë të arsyetimit ligjor të vendimit.

10.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se shkarkimi nga detyra është bazuar në një arsyetim të përgjithshëm dhe sipërfaqësor, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e ligjore dhe me frymën e reformës në drejtësi, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi nuk qëndron. Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit rezulton se masa disiplinore e shkarkimit është dhënë pas përfundimit të hetimit administrativ dhe mbi bazën e vlerësimit të elementeve faktike e provuese të administruara në dosje, në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Pretendimi i subjektit se, nëse Komisioni do të kishte zbatuar parimin e objektivitetit, do të arrinte në përfundimin për konfirmimin në detyrë, sikurse dhe evidentuar më lart, përbën në thelb një kundërshtim të vlerësimit përfundimtar të bërë nga Komisioni dhe jo një argument që evidenton shkelje konkrete të procesit të rregullt ligjor.

10.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se shumica e trupit gjykues të Komisionit ka pranuar pamundësinë objektive dhe ligjore për të vlerësuar kriterin e pasurisë, ndërkohë që ka vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra pikërisht mbi bazën e këtij kriteri, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e vendimit të ankimuar. Nga analiza e këtij të fundit rezulton se Komisioni ka ushtruar kompetencën e tij vlerësuese mbi kriterin e pasurisë, duke analizuar provat dhe rrethanat faktike të administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe duke arritur në përfundime konkrete mbi situatën pasurore të subjektit. Për rrjedhojë, pretendimi për ekzistencën e një pamundësie objektive apo ligjore për të vlerësuar, mbetet i pabazuar.

10.3.1. Sa i përket pretendimit se Komisioni e ka bazuar zgjidhjen e çështjes në zbatim analog të vendimmarrjes së Kolegjit ndaj subjektit tjetër të rivlerësimit, A. Y., trupi gjykues çmon se edhe ky argument nuk qëndron. Referimi ndaj standardeve të vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit, nuk përbën zbatim me analogji të një vendimi individual, në kuptimin e analogjisë ligjore, por referim ndaj standardeve të konsoliduara të Kolegjit, për garantimin e zbatimit uniform të ligjit, të sigurisë juridike dhe të trajtimit të barabartë të subjekteve të rivlerësimit.

10.4. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se nuk ka qenë më parë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe se deklarimin e parë e ka kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit, në vitin 2017, ndërsa vlerësimi i Komisionit i referohet një periudhe përpara ushtrimit të funksionit objekt rivlerësimi, trupi gjykues, sikurse është konsoliduar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se kontrolli i kriterit të pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit përfshin verifikimin e plotë të burimeve të krijimit të pasurisë, pavarësisht nëse ato i përkasin periudhës para ose pas ushtrimit të funksionit, për sa kohë lidhen me deklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 84/2016, për garantimin e integritetit të subjektit të rivlerësimit. Koha e emërimit në detyrë të subjekteve të rivlerësimit nuk kushtëzon për efekt të këtij procesi, shtrirjen e kontrollit të kriterit të pasurisë. Sa i përket pretendimit se konkluzioni i Komisionit mbi cenimin e besimit të publikut është i pabazuar, për shkak se subjekti, në cilësinë e ndihmëses ligjore, nuk ushtron funksion vendimmarrës, trupi gjykues vlerëson se ky argument, megjithëse relevant në kuadër të analizës së proporcionalitetit dhe të detyrës funksionale të subjektit, nuk është në vetvete përjashtues për vlerësimin nëse subjekti me veprimet e saj ka cenuar besimin e publikut. Ky standard nuk lidhet ekskluzivisht me ushtrimin e një funksioni formal vendimmarrës, por në vlerësim me integritetin, etikën dhe figurën e subjektit të rivlerësimit që, sipas Kushtetutës dhe ligjit, të gjithë funksionarët e sistemit të drejtësisë i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

10.5. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kundërshton arsyetimin e Komisionit mbi konstatimet për “fiktivitet” dhe veprime të kryera “në mashtrim të ligjit”, duke pretenduar se në mungesë të një kallëzimi penal sipas nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale, referimi i Komisionit ndaj këtyre termave mbetet i paqëndrueshëm dhe i pambështetur ligjërisht, trupi gjykues vlerëson në këtë fazë të shqyrtimit të shkaqeve procedurale, se ky pretendim nuk evidenton, në vetvete, ndonjë shkelje të procesit të rregullt ligjor apo mangësi procedurale, që të diktojë një trajtim të veçantë paraprak, por lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin e çështjes dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni. Në këto kushte, ky shkak ankimi do të marrë përgjigje gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e akteve të administruara në fashikull dhe vlerësimit që do t’iu bëhet në Kolegj rrethanave faktike të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

- 11.** Në përfundim, për sa analizuar më sipër, trupi gjykues nuk evidentoi situata ligjore të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do të sillnin nevojën e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, si dhe vendosi të vijojë me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, mbi bazë aktesh, sipas parashikimit të nenit 49, paragrafi 1 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku.

B. Vlerësimi i trupit gjykues për kriterin e pasurisë

B/1 Lidhur me gjendjen cash, në shumën 1.500.000 lekë, deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting

12. Komisioni ka vlerësuar se pamundësia financiare për justifikimin tërësisht të likuiditetit *cash*, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, prej 1.500.000 lekësh, dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në raport me shpjegimet e dhëna në drejtim të balancës negative të konstatuar, prej 600.000 lekësh, janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit pasuror gjatë procesit të vendimmarrjes.

12.1 Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, pretendon se, edhe nëse merret e mirëqenë ekzistenca e balancës negative prej 600.000 lekësh, kjo rrethanë, në konsideratë të zbatimit të parimit të proporcionalitetit në këtë proces, nuk përbën element që duhet të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes dhe, aq më pak, nuk mund të passjellë shkarkimin nga detyra të saj. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit i referohet jurisprudencës së mëparshme të Komisionit⁶, Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ⁷ Gjykatës së Lartë⁸ dhe GjEDNj-së.⁹

12.2 Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe shqyrtoi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, për këtë çështje, konstaton dhe vlerëson si vijon.

12.3 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar: “*Gjendje në cash në shumën 1.500.000 lekë. Burimi i krijimit: një pjesë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.07.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, si dhe një pjesë të ardhura nga pagat*”. Bashkëlidhur kësaj deklaratë, në funksion të deklarimeve, subjekti ka paraqitur¹⁰ këto akte:

(1) Vërtetim nr. {***} prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për periudhën nga 01.02.2009 – 01.03.2015. Të ardhura neto, në total në shumën 3.063.258 lekë.

(2) Vërtetim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***} prot., janar 2017, nga i cili rezulton se, për periudhën nga qershor 2016 – dhjetor 2016, subjekti ka realizuar të ardhura nga të cilat janë ndalur kontribute, në shumën totale 427.792 lekë.

(3) Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***}, datë 29.07.2014, me palë paditëse Majlinda Tosku dhe palë të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, nga i cili rezulton se subjekti ka përfutuar shumën prej 1.165.800 lekësh. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 19.11.2014. Nga të dhënat e Credins Bank

⁶ Vendimi nr. 242, datë 28.02.2020, subjekt rivlerësimi A. V., paragrafi 1.118 - 1.119; nr. 394, datë 07.06.2021, subjekt rivlerësimi V. Ç., paragrafi 12.5; nr. 324, datë 11.12.2020, subjekt rivlerësimi S. N., “Konkluzioni përfundimtar mbi pasurinë”.

⁷ Vendimi nr. 5/2019 (JR), subjekt rivlerësimi A. C., paragrafi 26 i tij.

⁸ Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00 - 2022 -3674 (416), datë 06.12.2022, paragrafi 15-20.

⁹ GjEDNj, çështja “Sevdari kundër Shqipërisë”.

¹⁰ Shih aneksin nr. 4/4 në dosjen ILDKPKI.

ShA rezulton se kjo shumë ka kaluar, në datën 09.12.2016, në llogarinë bankare të subjektit, me përshkrimin “*ekzekutim i vendimit nr. {***}, datë 29.07.2014*”.

(4) Vendimin nr. {***}, datë 25.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i formës së prerë, me palë paditëse Majlinda Tosku dhe palë të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, nga i cili subjekti ka përfituar shumën 84.600 lekë. Kjo shumë ka kaluar në llogarinë bankare të subjektit në Credins Bank, në datën 06.05.2016.

12.4 Sa administruar më sipër, Komisioni, duke iu referuar burimeve të krijimit të deklaruar nga subjekti, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka analizuar mundësinë financiare për të krijuar me të ardhura të ligjshme, gjendjen *cash* prej 1.500.000 lekësh.

- Për burimin “*Të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.07.2014*”, nisur nga veprimet bankare, Komisionit i ka rezultuar se shumën e përfituar nga ky vendim, në periudhën 09.12.2016 – 28.01.2017, subjekti e ka përdorur: (i) pjesërisht për të kryer pagesa/blerje të ndryshme, në një total prej 217.269 lekësh; (ii) për tërheqje *cash*, në një total prej 901.868 lekësh, si dhe (iii) si gjendje llogarie të mbartur në datën 28.01.2017, në shumën 147.590,60 lekë. Komisioni¹¹ ka konsideruar shumën në total prej 900.000 lekësh, si burim i ligjshëm për krijimin e gjendjes *cash* prej 1.500.000 lekësh.

- Për burimin e deklaruar “*Të ardhura nga paga*” ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të krijuar kursime *cash* nga pagat, pasi analiza financiare, për periudhën 01.02.2009 – 28.01.2017, ka rezultuar me një balancë negative prej (-) 15.197.368 lekësh.

12.5 Komisioni, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme likuiditetin në *cash* prej 600.000 lekësh, pjesë përbërëse e likuiditetit prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

12.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se: “*E vetmja analizë financiare analitike është tabela në faqen 4 të rezultateve të hetimit, analizë ku ndoshta nga pakujdesia nuk është përfshirë shuma prej 1.165.800 lekë, e përfituar nga ekzekutimi i vendimit nr. {***}, datë 29.07.2014. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 19.11.2014. Nga të dhënat bankare të Credins Bank rezulton se shuma prej 1.165.800 lekësh ka kaluar në llogarinë time bankare me përshkrimin: ‘ekzekutim i vendimit nr. {***}, datë 29.07.2014’*”.

12.7 Komisioni, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka çmuar se subjekti i rivlerësimit: “*Sipas shkronjës ‘b’, nuk justifikon tërësisht me të ardhura të ligjshme likuiditetin në cash prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*. Në lidhje me mosjustifikimin e likuiditetit në cash prej 600.000 lekësh, pjesë përbërëse e likuiditetit të deklaruar prej 1.500.000 lekësh, u vërtetua se kjo ka ardhur si pasojë e balancës negative prej -15.197.368 lekësh (në përfundim të procesit ndryshoi në -12.197.368 lekë), që i përket periudhës që subjekti nuk ka qenë subjekt i deklarimit. Është e vërtetë që barra e provës nuk i ka kaluar në mënyrë*

¹¹ Nisur nga shpenzimet në shumën 217.269 lekë dhe duke qenë se nga sistemi TIMS nuk ka të dhëna për udhëtime të subjektit në periudhën 09.12.2016 – 28.01.2017 dhe as të dhëna për investime në ndonjë pasuri.

specifike në lidhje me këtë balancë negative, por, duke qenë se kjo balancë ka qenë shkak i pamundësisë financiare të likuiditetit në cash prej 600.000 lekësh, vlerësohet se subjekti duhet të kishte dhënë parashtrime për ta kundërshtuar atë, e cila më së shumti është afektuar nga konsiderimi i shumave që kanë shkuar për shlyerjen e kredive si shpenzime të saj. [...] Megjithatë, sa i takon pamundësisë financiare për të krijuar likuiditetin në cash prej 600.000 lekësh, si rrethanë më vete, ky fakt nuk përbën shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në raport me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit”.

12.8 Në vlerësim të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se diferenca negative prej 600.000 lekësh, edhe nëse merret e mirëqenë, nuk duhet të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes.

12.8.1 Në analizë të qëndrimit të subjektit të rivlerësimit ndaj barrës së provës së kaluar nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se përgjigjet e dhëna nga subjekti, nuk rezultojnë shteruese dhe të mjaftueshme për të kundërshtuar rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me këtë diferencë. Megjithëse Komisioni i ka kaluar barrën e provës në lidhje me pamundësinë për justifikimin e likuiditetit *cash* prej 600.000 lekësh, subjekti nuk ka adresuar në mënyrë të plotë dhe konkrete shkakun themelor të kësaj pamundësie, që lidhet me balancën negative të konstatuar fillimisht, në shumën prej 15.197.368 lekësh, për periudhën përpara fillimit të detyrës.

12.8.2 Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se subjekti i rivlerësimit, as në shkaqet e ankimit, nuk është ndalur në mënyrë të posaçme në shpjegimin e diferencës negative të konstatuar për periudhën përpara fillimit të detyrës, duke e anashkaluar sërish këtë element dhe duke e kundërshtuar konkluzionin e arritur nga Komisioni, vetëm në drejtim të zbatimit të parimit të proporcionalitetit apo në referencë dhe të vendimmarrjeve të mëparshme në këtë proces. Në mungesë të një analize konkrete mbi zërat që kanë sjellë këtë diferencë, veçanërisht sa i takon shumave të përdorura për shlyerjen *cash* të kredive të marra nga subjekti, elemente që do të trajtohen më vete në vijim të arsytimit të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se diferenca negative e konstatuar, prej (-) 600.000 lekësh, në konsideratë dhe të jurisprudencës së krijuar në këtë proces, megjithëse nuk përbën shkak autonom për shkarkim, mbetet një rrethanë relevante për vlerësimin e saktësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

12.8.3 Në përfundim, lidhur me gjendjen *cash*, në shumën 1.500.000 lekë, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e saj, nga burimet e deklaruara, me një diferencë prej (-) 600.000 lekësh, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rrethanë e cila u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues, në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

B/2 Lidhur me pasurinë “godinë pesëkatëshe”, të ndodhur në rrugën “{}”, Tiranë***

13. Nisur nga një denoncim,¹² që ngre pretendime për fshehje pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit, konkretisht të një godine 5-katëshe, të regjistruar në emër të familjarëve të saj, Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ mbi këtë pasuri, arriti në përfundimin se subjekti sipas nenit 33, pika 5, shkronja

¹² Denoncim i shtetasit N. Ç., protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 01.06.2020.

“a” e ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklarime të pasakta dhe që bien në kundërshtim me ligjin, për shkak të mosdeklarimit të përdorimit dhe posedimit të kësaj pasurie, si dhe të të ardhurave të përfituara në rrugë bankare nga dhënia e saj me qira.

13.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke iu referuar mendimit të pakicës, i cili, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se, ndonëse nga rrethanat duket se është krijuar një konfuzion ndërfamiljar, *së pari*, pasaktësitë në deklarime dhe përfshirja e subjektit në veprimet financiare brenda familjes nuk përmbushin elementet e fshehjes së pasurisë dhe, *së dyti*, rrethanat në të cilat kanë ndodhur këto veprime, përpara marrjes së detyrës nga subjekti dhe në konsideratë të marrëdhënieve familjare, nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkim.

13.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe shqyrtoi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, për këtë çështje, konstaton dhe vlerëson si vijon.

13.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë të gjendjes civile dhe si adresë vendbanimi: “*Njësia nr. {***}, apartamenti nr. {***}, në katin e dytë të godinës 5 kate, në rrugën {***}, Tiranë*”¹³. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë/përdorimin/posedimin e ndonjë pasurie të paluajtshme. Edhe në rubrikën “*nëse dispononi vendqëndrim tjetër*”, subjekti nuk ka deklaruar ndonjë banesë.

13.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, nga momenti që ka marrë detyrën e *deri më sot*, ka banuar në shtëpinë e nënës së saj, në adresën e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për të cilën nuk ka paguar ndonjëherë qira. Gjatë gjithë periudhës së deklaramentit, subjekti ka deklaruar se ka në përdorim një pjesë të apartamentit (68,4 m²) në pronësi të nënës së saj, znj. D. T., në posedim të të cilit ka qenë që nga viti 2012 dhe aktualisht. Subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë datë 19.09.2019, për pasurinë me nr. {***}, me sipërfaqe 138.4 m,² në emër të nënës së saj, D. T.

Në përgjigje të pyetjes “*Që kur keni filluar detyrën deri sot, a keni marrë ndonjë vlerë qiraje apo të ardhura të tjera?*”, në të njëjtin pyetësor, subjekti ka deklaruar se: “[...] nga apartamenti në pronësi të nënës sime, D. T., me nr. pasurie {***}, në z. k. {***}, në të cilin unë banoj, një pjesë (70 m²) është dhënë me qira sipas kontratës së qirasë nr. {***} rep., {***} kol. datë 05.07.2019. Nga data 07.01.2021 deri në datën 01.05.2021 (datë në të cilën është zgjidhur kjo kontratë qiraje) më ka kaluar pagesa e qirasë në shumën 36 000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë / muaj për nënën time, e cila nuk ka të hapur asnjë llogari bankare. Kjo shumë përmban detyrimin për qiranë, si dhe pagesën për energji elektrike dhe furnizim me ujë të pijshëm. Sipas kontratës së qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.05.2021 e në vijim, kjo pjesë e apartamentit i është dhënë me qira një tjetër shtetasi. Përsëri, pagesa e qirasë bëhet në llogarinë time pranë Intesa Sanpaolo Bank (referohu nenit 3 të kësaj Kontrate) në vlerën 40.000 lekë/muaj. Sipas kontratave të qirave, tatimet paguhen nga qiramarrësi, detyrim i përcaktuar në nenin 3”.

¹³ ILDKPKI ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar: (i) të ketë në pronësi pasuri të paluajtshme në adresën e mësipërme; (ii) të ketë marrë me qira pasuri të paluajtshme në adresën e mësipërme; (iii) të ketë në posedim ose në përdorim pasuri të paluajtshme në adresën e mësipërme.

13.5. Në lidhje me të ardhurat nga qiratë, nga kontratat e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve, verifikimi i llogarive bankare, si dhe nga hetimi administrativ i Komisionit,¹⁴ ka rezultuar se janë lidhur këto kontrata dhe janë realizuar këto të ardhura:

(1) Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.07.2019, me qiradhënëse D. T., qiramarrëse “{***}” ShPK, me një afat 2-vjeçar, nga data 01.05.2019 – 01.05.2021, me objekt marrjen me qira të një sipërfaqeje prej 70 m². Në kontratë është përcaktuar që objekti ndodhet në katin e tretë të godinës. Numri i pasurisë fillimisht ka qenë {***} (kati i tretë), por është korrigjuar me shkrim dore, duke u ndryshuar vetëm numri 3 në 2, pa u shoqëruar me vulën dhe firmën e noteres.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se pagesa e qirasë për këtë kontratë i ka kaluar asaj në rrugë bankare, nga data 07.01.2021 – 01.05.2021, pasi nëna e subjektit nuk ka pasur llogari bankare, pa dhënë shpjegime se ku kanë shkuar të ardhurat nga qiraja jashtë kësaj periudhe. Nga verifikimi i llogarive të subjektit, në Tirana Bank ShA, rezultoi se janë kryer pagesa qiraje nga shtetasi S. R. E., për periudhën 06.11.2020 – 05.05.2021, me përshkrimin “*TRN nga S. R. E. pagese qiraje*”, i cili ka kryer pagesë qiraje për “{***}” ShPK. Pagesa e qirasë së likuiduar është në shumën 36.000 lekë në muaj dhe totali i kaluar për periudhën në fjalë është në shumën 251.750 lekë. Të ardhurat e qirasë janë tërhequr *cash* nga subjekti.

(2) Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.05.2021, sipas të cilës i është dhënë me qira z. G. Ç., për një afat 2-vjeçar, nga data 01.06.2021 – 01.06.2023, pasuria nr. {***}, me sipërfaqe 70 m², kundrejt vlerës 40.000 lekë/muaj. Qiraja është parashikuar t’i kalojë subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku, në cilësinë e vajzës së qiradhënëses.

Në përgjigjen e pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka dhënë informacion në lidhje me mënyrën e përfitimit të këtyre të ardhurave. Nga verifikimi i llogarive të subjektit, në të gjitha bankat e nivelit të dytë, rezultoi se në Intesa Sanpaolo Bank ShA janë kryer pagesa qiraje nga shtetasi G. Ç., për periudhën 10.06.2021 – 04.02.2022, me përshkrimin: “*G. T. Ç. për Majlinda Tosku, derdhje qiraje sipas kontratës për llogari të qiradhënëses D. T.*”. Pagesa e qirasë së likuiduar është në shumën 40.000 lekë në muaj dhe totali i kaluar për periudhën në fjalë është në shumën 400.000 lekë. Të ardhurat e qirasë janë tërhequr *cash* nga subjekti.

(3) Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.04.2009, sipas të cilës D. T. i ka dhënë me qira znj. M. B., për një afat 5-vjeçar, nga data 01.12.2008 – 01.12.2013, kundrejt vlerës 900 euro në muaj, pasurinë me sipërfaqe 155 m², kati i dytë i godinës 5-katëshe, ndodhur në Tiranë, rruga “{***}”. Qiraja është parashikuar të paguhet në *cash*.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk ka arritur të gjejë të dhëna, por se pagesa e qirasë nuk ka kaluar në llogarinë e saj bankare. Nga verifikimi i llogarive të subjektit, në të gjitha bankat e nivelit të dytë, nuk rezultoi që për këtë kontratë të jenë kryer pagesa qiraje nga qiramarrësja M. B.

(4) Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.04.2019, sipas të cilës D. T. i ka dhënë me qira qendrës “{***}”, apartamentin nr. {***}, pasurinë me nr. {***} (kati i tretë), rruga “{***}”, për

¹⁴ Nga informacioni i dërguar në Komision nga institucioni financiar fondi “Besa”.

një afat 2-vjeçar, nga data 01.05.2019 – 28.02.2021, kundrejt vlerës 330 euro në muaj. Qiraja është parashikuar të likuidohet në *cash* ose në llogari bankare.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka dhënë përgjigje për këtë kontratë, por i është referuar një kontrate tjetër, të lidhur më datë 18.09.2020, midis të njëjtëve palë, por me afat 4-mujor. Nga verifikimi i llogarive të subjektit, në të gjitha bankat e nivelit të dytë, nuk rezultoi që për kontratën në fjalë të jenë kryer pagesa qiraje nga qiramarrësi, qendra “{***}”.

(5) Po ashtu, nga lëvizjet bankare në llogarinë në Credins Bank ShA, evidentohet se për periudhën 10.11.2014 – 05.02.2016, në emër të subjektit të rivlerësimit janë kredituar në total 510.000 lekë, me përshkrimin: “*Likuidim qira*”, të cilat janë tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit.

(6) Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2020, me palë qiradhënëse D. T. dhe palë qiramarrëse qendra “{***}”, me afat 4-mujor, nga data 01.09.2020 – 31.12.2020, e cila parashikon se qiraja do t'i kalojë qiradhënëses, nëpërmjet bankës.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat nga qiratë për këto katër muaj, nëna i ka marrë në formë *cash*. Nga verifikimi i llogarive të subjektit të rivlerësimit, në të gjitha bankat e nivelit të dytë, nuk rezultoi që për kontratën në fjalë të jenë kryer pagesa qiraje nga qiramarrësi, qendra “{***}”.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion edhe disa kontrata të tjera qiraje, që pretendon se ka arritur të sigurojë nga prindërit dhe nga i vëllai, G. T., në të cilat ajo nuk ka qenë palë kontraktore. Nga të dhënat bankare nuk ka të dhëna që qiratë për këto kontrata të kenë kaluar në llogari të subjektit.

(7) Në llogarinë bankare të subjektit, në Bankën Kombëtare Tregtare, rezulton edhe një pagesë qiraje në shumën 25.500 lekë, në datën 02.08.2016, kryer nga S. J., e cila nuk lidhet me ndonjë nga kontratat e deklaruara dhe të administruara.

13.6. Me pyetësin nr. 2, Komisioni, për shkak të paqartësisë mbi pasuritë pjesë përbërëse të objektit pesëkatësh të dhëna me qira, i kërkoi subjektit të japë shpjegime, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues, se cilës pasuri i përkisnin këto pagesa dhe, nëse këto të ardhura i kanë kaluar nënës së subjektit, mënyrën e likuidimit të qirave në favor të saj.

13.7. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime se cilës pasuri i përkisnin këto pagesa. Sipas subjektit, nisur nga fakti që marrëdhënia nënë - vajzë është një marrëdhënie shumë e ngushtë familjare, mënyrën e dhënies së qirasë ndërmjet tyre nuk e kanë rregulluar me ndonjë veprim juridik, dhe shumat e marra me qira janë përdorur nga nëna sipas nevojave të momentit. Subjekti shprehet se nuk i ka konsideruar qiratë si të ardhurat e saj, pasi pasuria ka qenë e nënës, D. T., dhe të ardhurat janë përfituar prej saj nga llogaria e saj bankare. Sa i përket kontratës së qirasë, të lidhur midis nënës së subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti paraqiti deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 03.11.2014, të nënës së saj dhe kësaj shoqërie “{***}” ShPK, në të cilën palët deklarojnë se kanë lidhur një kontratë qiraje dhe çmimi real që pala qiramarrëse do të paguajë çdo muaj

është 35.000 lekë, shumë të cilën shoqëria ia jepte në dorë. Kjo deklaratë nuk përmban të dhëna mbi pasurinë objekt qiraje dhe as mbi afatin e kontratës, për të cilën subjekti pretendon se nuk ka arritur ta gjejë, pasi sipas subjektit, referuar ligjit “Për noterinë”, këto lloj kontrata qiraje me afat të shkurtër, nuk mund të ruhen për një kohë kaq të gjatë.

13.8. Komisioni ka arsyetuar se është i pavërtetë deklarimi i subjektit se, duke qenë se ka kaluar afati i ruajtjes së këtij tipi kontratash, referuar ligjit “Për noterinë”, nuk ka mundësi ta sigurojë këtë kontratë, pasi sipas udhëzimit nr. 23, datë 07.12.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, afati i ruajtjes së kontratave të qirasë është 10 vjet pas afatit që dokumenti parashikon të ketë efekte juridike dhe, kur nuk e ka një të tillë, 10 vjet nga dita e regjistrimit të aktit. Ndërkohë që deklarata noteriale e paraqitur nga subjekti është e datës 03.11.2014 dhe pagesat e qirasë i përkasin periudhës 2014 – 2016, pra brenda afatit 10-vjeçar të ruajtjes së kontratave.

13.9. Komisionit, në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me godinën 5-katëshe, në rrugën “{***}”, Tiranë, i ka rezultuar se: (i) Objekti pesëkatësh duket të jetë ndërtuar gjatë viteve 2000 deri në vitin 2006, kur është aplikuar për leje legalizimi nga babai i subjektit (nuk ka të dhëna për punësimin e subjektit në vitet 2006 dhe 2007) dhe leja e legalizimit ka dalë në emër të nënës së subjektit, në vitin 2011¹⁵ (kur subjekti ka qenë juriste në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave). Pasi e gjithë godina është regjistruar fillimisht në emër të nënës së subjektit, në vitin 2011, në vijim, nëpërmjet disa akteve noteriale, pronësia mbi pjesët përbërëse të saj ka kaluar në emër të nënës së subjektit dhe vëllezërve të saj¹⁶. (ii) Subjekti ka deklaruar se objekti pesëkatësh është ndërtuar me kontribut të vëllezërve të saj, G. dhe A. T., por nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar punësimin dhe të ardhura të përfituara nga vëllezërit e saj (me përjashtim të vëllait, G. T., për të cilin ka vërtetuar punësimin si Oficer i Policisë Gjyqësore, për një periudhë dyvjeçare).¹⁷ (iii) Furnizuesi i Shërbimit Universal ka konfirmuar Komisionin se, në emër të znj. D. T., figuron kontrata me nr. {***}, që i përket pasurisë nr. {***}. Kjo kontratë është hapur më datë 18.12.2006, faturohet që nga janari i vitit 2007, si dhe ka ndryshim emri, nga abonenti Majlinda Tosku në D. T., në datën 26.09.2015.¹⁸ Pra, fillimisht, kjo kontratë është hapur në emër të subjektit të rivlerësimit në vitin 2006 dhe furnizimi me energji është bërë që nga janari i vitit 2007. Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë¹⁹ ka konfirmuar kontratën me nr. {***}, në emër të D. T., për këtë pasuri.

13.10. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, Komisioni, sipas nenit 52 të ligjit

¹⁵ Referuar akteve të administruara në Komision nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe nga dosja e legalizimit të këtij objekti.

¹⁶ Më pas, pasuria është ndarë në pesë njësi të veçanta, të regjistruara si vijon: Pasuria nr. {***}, njësi shërbimi në katin përdhe, me sipërfaqe 126.6 m² është në pronësi të A. T., vëllai i subjektit; Pasuria me nr. {***}, apartament me sipërfaqe 126.6 m², është në pronësi të A. T.; Pasuria me nr. {***}, apartament me sipërfaqe 126.6 m², është në pronësi të D. T.; Pasuria me nr. {***}, apartament me sipërfaqe 126.6 m², është në pronësi të G. T., vëllai i subjektit; Pasuria me nr. {***}, me sipërfaqe 126.6 m², është në pronësi të Majlinda Toskut, e cila e ka blerë nga vëllai, G. T. (siç tregon Kontrata e Shitblerjes së Pasurisë së Paluajtshme me Kusht Kreditimi, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2020).

¹⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

¹⁸ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2022, të FSHU-së, në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 18.02.2022, të UK Tiranë ShA, në dosjen e Komisionit.

nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës dhe i ka kërkuar të japë shpjegime e të sjellë dokumentacion provues, për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit se subjekti është sjellë si pronare e pasurisë nr. {***}, nuk ka deklaruar përdorimin/posedimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas kërkesave të shtojcës nr. 2 dhe formularit të deklarimit *vetting*, sipas ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet shprehimisht detyrimi i subjekteve për të deklaruar pasuri në përdorim dhe burimin e krijimit të tyre.

13.11. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] Për sa më sipër, ju sqaroj se kam deklaruar adresën si më sipër si të vetmen adresë ku kam jetuar. Banesa në të cilën jetoja nuk ishte/është në pronësinë time dhe as posedohej nga unë. Unë jetoja së bashku me prindërit e mi dhe nëse ky deklarim çmohet si pasaktësi nga ana juaj, është i paqëllimshëm, pasi vetë Formulari i Deklarimit është i orientuar drejt pasurive të akumuluar, pjesës takuese në këto pasuri, si dhe burimin e krijimit. Banesa e prindërve të mi ka qenë dhe është 100 % në pronësi të tyre. [...]”. Lidhur me të ardhurat nga qiraja, subjekti ka shpjeguar se ato i kanë kaluar prindërve, babait të ndjerë dhe nënës, me qëllim për të përballuar jetesën dhe sëmundjet e vazhdueshme. Sa kohë këto të ardhura kanë pasur destinacion të përcaktuar, nuk i ka konsideruar asnjëherë të ardhura për llogarinë e saj. Veprimet në llogaritë e saj bankare kanë qenë të orientuara për t’u qëndruar afër prindërve dhe t’u shmangë atyre kohën nëpër banka. Subjekti shprehet se: “[...] Me qëllim lehtësimin e veprimeve të tyre jashtë shtëpisë (sepse brenda saj ishin/janë më të dobishëm) jam munduar që një pjesë të veprimeve formale-burokratike t’i kryej unë. Pasuria nr. {***} është e vetmja pasuri në emër dhe pronësi të prindërve të mi, të cilët kanë punuar dhe sakrifikuar gjithë jetën - pak por e sigurt. Nuk kam qenë, nuk jam dhe nuk kam kurajë të sillem sikur kjo pronë është e imja. [...]”.

13.12. Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, nuk dha shpjegime dhe nuk solli dokumentacion mbi kontratën e qirasë që lidhej me pagesën e kryer nga S. J. Sa i përket arsyeve për mosgjatjen e kontratave, subjekti ndryshoi qëndrimin e saj, ku në përgjigje të pyetësorëve, duke referuar ligjin “Për noterinë”, është shprehur se, për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nuk ka mundësi ta sigurojë këtë kontratë, duke paraqitur një arsye të re, me pretendimin se, për shkak të mungesës së cilësisë së palës kontraktore në këto kontrata, e kishte të vështirë të identifikonte kohën dhe formën e lidhjes së saj.

13.13. Komisioni, në vijim, ka arsyetuar se deklarimet e subjektit nuk mund të vlerësohen të besueshme për sa kohë: (i) në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk ka deklaruar as përdorimin/posedimin e pasurisë nr. {***} dhe as të ardhurat nga qiraja të kredituara në llogarinë e saj, të paktën për periudhën 10.11.2014 – 05.02.2016, në shumën 510.000 lekë, ndonëse kishte detyrimin ligjor për t’i deklaruar; (ii) nëna e subjektit ka përfituar të ardhura të konsiderueshme nga dhënia me qira e pasurive të tjera, pjesë përbërëse të godinës pesëkatëshe, me të cilat mund të përballonte shpenzimet e jetesës; (iii) mbetet e paqartë përse në emër të nënës nuk është hapur një llogari bankare, ku të depozitoheshin këto të ardhura, ndërkohë që në llogarinë e subjektit kanë kaluar vetëm të ardhurat nga pasuria nr. {***}. Gjithashtu, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me faktin se kontrata e energjisë elektrike për këtë pasuri është lidhur fillimisht në emrin e saj, në vitin 2006, dhe më pas ka kaluar në emër të nënës, në vitin 2015, ndonëse ajo ka deklaruar në vijimësi se nuk ka pasur asnjë lidhje apo kontribut në këtë pasuri.

Po ashtu, Komisioni ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi i subjektit, se pasuria nuk është poseduar prej saj, pasi nga të dhënat e hetimit administrativ, rezulton se, të paktën që nga viti 2012, ajo e ka përdorur dhe poseduar këtë pasuri, fakt i deklaruar edhe në përgjigje të pyetësorit standard, ndërkohë që, referuar nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti kishte detyrimin të deklaronte pasuritë jo vetëm në pronësi, por edhe në posedim apo përdorim.

13.14. Trupi gjykues i Kolegjit, sa konstatuar më sipër, vlerëson se gjatë hetimit administrativ, në Komision rezultoi e provuar se: (i) subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar si adresë banimi: *Njësia nr. {***}, apartamenti nr. {***}, në katin e dytë të godinës 5-kate, në rrugën "{***}"*, Tiranë; (ii) në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se *"ka hyrë në posedim të një pjese të apartamentit, në emër të nënës së subjektit, që ndodhet në katin e dytë të një godine 5-katëshe, që nga viti 2012, si dhe e posedon atë aktualisht"*; (iii) kontrata e energjisë elektrike, për këtë pasuri është lidhur në emër të subjektit, në vitin 2006, dhe ka kaluar në emër të nënës së subjektit, vetëm në vitin 2015; (iv) në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se në emër të subjektit të rivlerësimit kanë kaluar shuma të konsiderueshme nga dhënia me qira e kësaj pasurie deri në datën e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, të cilat subjekti nuk i ka deklaruar apo shpjeguar sepse ato nuk i përkisnin asaj, por nënës së saj, sikurse ka pretenduar gjatë hetimit administrativ. Të gjitha këto rrethana tregojnë se marrëdhënia e subjektit me këtë pasuri përmban elemente të mjaftueshme që do ta kualifikonin si një e drejtë përdorimi, e cila duhej deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe duke mundësuar kontrollin e plotë të saj nga organet e rivlerësimit.

13.14.1. Nga leximi i kombinuar i dispozitave që rregullojnë deklarimin e pasurive në funksion të procesit të rivlerësimit nga subjektet – konkretisht neni D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe përkufizimit të pasurive që i nënshtrohen deklarimit për efekt të këtij procesi, sipas nenit 3, pikës 11, të po këtij ligji, rezulton qartë detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar këtë pasuri, të cilën e kishte në përdorim prej vitesh deri në momentin e depozitimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Në këto kushte, rezulton qartazi se nuk mund të quhet i ezauruar ky detyrim kushtetues, duke shkruar në deklaratë adresën e vendbanimit, pa asnjë të dhënë për marrëdhënien e saj afatgjatë me këtë pasuri. Nga ana tjetër, nëse do të pranohej kjo rrethanë, kontrollit do t'i nënshtroheshin pasuritë sipas adresave të vendbanimeve të subjekteve të rivlerësimit dhe jo pasuritë në përdorim e posedim. Po ashtu, ky kuadër normativ, i cili synon kontrollin e burimit të krijimit të pasurive, përfshin në këtë detyrim edhe kontrollin mbi pasuritë, për të cilat subjektet kanë lidhur ose përfitojnë nga veprime juridike të tjera, siç janë qiratë. Një deklaram i tillë, nëse do të kishte ndodhur, do të kishte qartësuar situatat, të cilat u evidentuan vetëm nga hetimi administrativ në Komision.

13.14.2. Komisioni ka kryer hetime të mëtejshme për të verifikuar vërtetësinë e deklarameve të subjektit rreth kësaj pasurie, në të gjitha komponentët e saj, që kanë të bëjnë me kohën e krijimit, burimet e financimit, pasurinë konkrete të dhënë me qira, si në pyetësorët e drejtuar subjektit të rivlerësimit, ashtu dhe në rezultatet e hetimit administrativ. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se rrethanat e konstatuara në tërësinë e tyre krijojnë një panoramë të paqartë dhe jo të besueshme lidhur me deklaramet e subjektit. Konkretisht: (i) mosdeklarami në deklaratën e pasurisë *vetting* i përdorimit/posedimit të pasurisë nr. {***}; (ii) mungesa e saktësisë të pjesëve konkrete të godinës të dhëna me qira; (iii) mosqartësimi i destinacionit të shumave të kredituara në llogarinë e saj nga qiratë, të cilat janë tërhequr *cash* nga subjekti, si dhe ndryshimi i shpjegimeve lidhur me arsyet e mosqartësisë së kontratave të qirasë, nuk lejojnë

krijimin e një bindjeje të qëndrueshme mbi saktësinë dhe koherencën e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

13.14.3. Nga analizimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit, rezulton se ato kanë qenë të paplota, joshteruese dhe të pashoqëruara me dokumentacion provues, duke dhënë kështu një tablo të paqartë, me të dhëna kontradiktore rreth elementeve të mësipërme, situatë e cila u vlerësua nga trupi gjykues në kontekstin e kriterit të vlerësimit të pasurisë.

13.14.4. Në përfundim të sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të përdorimit të pasurisë, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklarime të pasakta lidhur me marrëdhënien e qirasë për objektin në fjalë, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “a” e këtij ligji.

B/3 Lidhur me kreditë e përfituara nga fondi “Besa”

Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në veprimet/mosveprimet që e vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar gjetjet lidhur me kreditë e subjektit të rivlerësimit të marra nga fondi “Besa”. Lidhur me këto kredi, Komisioni ka arritur në konkluzionin se deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ kanë qenë kontradiktore dhe janë çmuar si përpjekje për të fshehur qëllimin e vërtetë të marrjes së tyre. Në këtë kuadër është konstatuar se subjekti, në mënyrë të përsëritur, ka marrë kredi për investime në aktivitete private, që nuk rezultojnë të jenë ushtruar prej saj apo familjarëve të saj, ka kryer deklarime të rreme në formularët e marrjes së tyre, si dhe nuk ka provuar qëllimin e kredive duke ndryshuar në mënyrë të përsëritur deklarimet lidhur me destinacionin e tyre. Komisioni ka vlerësuar se nuk janë vërtetuar deklarimet e subjektit lidhur me burimet e shlyerjes së kredive, të cilat janë likuiduar *cash* nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me aktivitetin e avokatisë, si person fizik, i cili siç pretendon subjekti që nuk është ushtruar asnjëherë prej subjektit të rivlerësimit dhe për të cilin vijon të jetë debitore, Komisioni ka vlerësuar se, pas kërkesës që vetë subjekti ka paraqitur në Qendrën Kombëtare të Biznesit (në vijim “QKB”), në vitin 2009, nuk ka bërë asnjë përçapje për çregjistrimin e ushtrimit të këtij aktiviteti, përkundrazi, e ka përdorur në mënyrë të përsëritur, me qëllim marrjen e disa kredive për nevoja të biznesit, destinacioni i të cilave mbeti i paprovuar sipas parashikimit në kontratat përkatëse të kredive, veprimeve të cilat janë konsideruar nga Komisioni të jenë kryer në mashtrim të ligjit.

13.15. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit dhe në parashtrime, pretendon se konkluzionet e arritura në vendimin përfundimtar të Komisionit janë të gabuara dhe nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm të provave të administruara gjatë hetimit, të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, si dhe shpjegimeve të dhëna prej saj gjatë hetimit administrativ. Subjekti pretendon se ka dhënë shpjegime të hollësishme dhe ka vërtetuar që veprimet e saj nuk bien ndesh me ligjin, si dhe me qëllimin e të gjithë procesit të rivlerësimit. Sa i përket aktivitetit të regjistruar si person fizik, me objekt “avokatinë”, subjekti shpjegon se nuk është anëtare e Dhomës së Avokatisë në Republikën e

Shqipërisë dhe nuk paguan kuotizacionin e përvitshëm pranë saj, e rrjedhimisht, sipas nenit 14 të ligjit “Për avokatinë”, e ka të ndaluar të ushtrojë profesionin e avokatit në çfarëdo lloj mënyre. Për më tepër, subjekti pretendon se, pavarësisht që ka provuar me akte shkresore se ka kërkuar çregjistrimin e aktivitetit, konfirmuar edhe nga shkresa e datës 05.10.2009, e QKB-së, Komisioni sërish ka arsyetuar se nga ana e subjektit ka pasur “mungesë përçapje” për çregjistrim.

13.16. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe shqyrtoi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, për këtë çështje, konstaton dhe vlerëson si vijon.

13.17. Institucioni financiar fondi “Besa”, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.02.2022, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Tosku, është financuar me katër kredi prej tij, konkretisht:

(i) Me kontratë huaje (me garanci *peng*), nr. {***} kol., {***} rep., datë 15.01.2009, subjekti ka përfituar në datën 16.01.2009, kredi në shumën 300.000 lekë, me afat 12 muaj. Arsyeja e përdorimit është “*për aktivitetin e punësuar*”.

(ii) Kjo kredi është shlyer pjesërisht nga subjekti, me një kredi tjetër, të marrë me kontratë huaje dhe hipotekore, nr. {***} kol., {***} rep., datë 30.04.2009, në shumën 2.500.000 lekë, me afat 57 muaj. Në pikën 10, të kësaj kontrate parashikohet se: “*Huamarrësi merr përsipër të përdorë kredinë për aktivitetin ‘avokate’, në rastet e ndryshimit të adresës së banimit dhe të aktivitetit duhet të njoftojë menjëherë huadhënësin*”. Në formularin e aplikimit, subjekti ka deklaruar se do të marrë kredi biznesi si avokate (ndërkohë që ka qenë juriste në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave), në shumën prej 2.500.000 lekësh, me qëllim kryerje punimesh dhe blerje pajisjesh për krijimin e një biznesi të ri “bar-restorant”, në objektin e lënë si garanci (*duke qenë se punon si avokate dhe si asistente notere në zyrën e noteres M. D., e cila është edhe noteria e fondit “Besa”*), biznes që do të krijohet përballë shkollës “{***}”. Nga të dhënat në QKB dhe të dhënat e përcjella në Komision, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se subjekti është e regjistruar si person fizik, me shërbim avokatie, që në vitin 2009, por nuk e ka ushtruar aktivitetin, nuk ka paguar detyrimet ligjore, si dhe nuk ka përfituar të ardhura si avokate. Kjo kredi është shlyer nga subjekti.

(iii) Me kontratë huaje dhe hipotekore nr. {***} kol., {***} rep., datë 09.04.2013, subjekti ka përfituar, në datën 12.04.2013, kredi në shumën 3.000.000 lekë, me afat 84 muaj. Në pikën 2.3 të saj parashikohet se: “*Kjo hua jepet për financim e investime. Huamarrësi nuk mund të përdorë huan për qëllime të tjera*”. Në pikën 4.7 parashikohet se: “*Të përdorë huan vetëm për aktivitetin për të cilin ajo është marrë. Në rastin e ndryshimit të aktivitetit, ai duhet të njoftojë Huadhënësin*”. Kjo kredi është shlyer nga subjekti.

(iv) Me kontratën nr. {***} rep., {***} kol., datë 25.09.2019, subjekti ka përfituar në datën 27.09.2019, kredi në shumën 50.000 lekë, me afat 120 muaj, detyrim i cili vijon të jetë aktiv. Në pikën 2.3 të saj parashikohet se kjo kredi jepet për investime.

13.18. Po ashtu, Banka Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”), me shkresën nr. {***} prot., datë 25.02.2022, ka përcjellë në Komision informacion dhe mbi një kredi të marrë nga subjekti pranë kësaj

banke, në vlerën 500.000 lekë, me kontratën e kredisë bankare konsumatorë, datë 26.12.2017, e cila do të përdorej për rregullim dhe mobilim shtëpie, e shlyer nga subjekti në vitin 2021. Në formularin e aplikimit për marrjen e kredisë, subjekti ka deklaruar se ka në pronësi dhe banon mbi 10 vite në adresën: rruga “{***}” dhe “{***}”, vila nr. {***}, Tiranë. Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pronë në deklaratën e pasurisë *vetting*, ndërkohë që në formularin e aplikimit për kredi pranë BKT-së e ka deklaruar veten si pronare. Komisioni vlerësoi se destinacioni i përdorimit të kredisë mbetet i paqartë, megjithëse ajo rezultoi e shlyer nga subjekti. Deklarimet e saj në formular rezultojnë në kundërshtim me gjendjen faktike, pasi subjekti nuk ka qenë pronare e godinës pesëkatëshe, por e ka fituar pronësinë mbi apartamentin në katin e katërt, vetëm në vitin 2022.

13.19. Ndërkohë, rezultoi se me shkresat nr. {***} prot., datë 03.08.2017 dhe datë 28.08.2017, administruar nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve/Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, konfirmojnë se Majlinda Tosku është regjistruar me NIPT {***}, si person fizik pranë QKB-së, me aktivitet me fushë veprimtarie “avokat”, nga data 08.01.2009, dhe është çregjistruar në datën 15.09.2020 (*gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Subjekti person fizik, Majlinda Tosku, nuk ka kryer asnjë deklaram për kontribute shoqërore, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatim i thjeshtuar mbi fitimin. Ky subjekt ka kaluar në status “pasiv”, që nga data 29.12.2014, si dhe ka gjoba në sistemin informatik, në shumën 10.000 lekë, dhe 60 deklarata të padorëzuara²⁰.

13.20. Sa i takon prindërve të subjektit, gjatë hetimit administrativ, nuk ka rezultuar të kenë qenë apo të jenë të regjistruar si persona fizikë apo juridikë. Ndërsa, për sa i takon vëllezërve të subjektit rezultoi se vëllai i subjektit, G. T., figuron të jetë i regjistruar në QKB, person fizik më datë 14.12.2017, pajisur me NIPT {***}, me objekt veprimtarie “bar-kafe”, me status “aktiv”. Ndërsa vëllai tjetër, A. T., figuron se në datën 14.12.2017 e ka pezulluar NIPT-in {***}, që ka pasur të regjistruar në datën 13.01.2014, në QKB, si person fizik, me objekt veprimtarie “bar-kafe”.

13.21. Subjekti i rivlerësimit, në formularin e aplikimit për marrjen e kredisë, në datën 30.04.2009, në shumën 2.500.000 lekë, ka deklaruar se ka punuar si asistent notere pranë noteres M. D. dhe ka paraqitur vërtetimin të lëshuar nga kjo e fundit, sipas të cilit, subjekti ka qenë e punësuar pranë zyrës së saj, në pozicionin “asistente notere”, me pagë mujore 80.000 lekë/muaj, që nga data 19.08.2008. Ndërkohë nga aktet rezultoi se, me komunikimin elektronik të datës 13.12.2023, noterja M. D., është përgjigjur në Komision se: *“Me sa mbaj mend, për shkak të kohës shumë të gjatë, shtetasja Majlinda Tosku më ka kërkuar të punësohej në zyrën time noteriale me kohë të pjesshme. Jemi dakordësuar për këtë marrëdhënie dhe për kushtet e punës, dhe është paraqitur dhe ka punuar pak ditë në zyrën time noteriale, datën e saktë nuk e mbaj mend. Me qëllim lidhjen e kontratës së punës, si dhe deklaramin në tatime dhe sigurime shoqërore, si dhe krijimin e dosjes personale si punonjëse, i kam kërkuar dokumentacionin përkatës. Majlinda Tosku nuk ma vuri në dispozicion dhe më njoftoi se do vazhdonte të punonte në shtet dhe nuk erdhi më në zyrën time të punonte. Në këto kushte, Majlinda Tosku nuk ka punuar dhe nuk ka qenë e regjistruar në organe tatimore dhe sigurime shoqërore pranë zyrës sime noteriale”*.

²⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.02.2022, QKB, me kërkesë të Komisionit, ka vërtetuar se Majlinda Tosku ka qenë e regjistruar në datën 08.01.2009 si person fizik, pajisur me NIPT {***} dhe e ka çregjistruar si aktivitet në datën 15.09.2020.

13.22. Me pyetësonin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime dhe dokumentacion provues lidhur me faktin, nëse kreditë e marra në vitet 2009, 2013 dhe 2019 janë përdorur në përputhje me qëllimin e deklaruar në kontratat përkatëse. Konkretisht, është kërkuar të provohet nëse kredia e vitit 2009 është përdorur për aktivitetin me shërbim avokatie apo krijimin e biznesit “bar-restorant”, se për cilin biznes është marrë kredia e vitit 2013, si dhe nëse kredia e vitit 2019 ka shërbyer për investime në aktivitete hotelerie, nga subjekti ose familjarët e saj, të vërtetuara këto me dokumentacion shkresor.

13.23. Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti ka dhënë këto shpjegime:

(i) *Lidhur me kredinë e marrë në datën 30.04.2009*, subjekti ka shpjeguar se, gjatë periudhës 2009 – 2013, as ajo dhe as familjarët e saj, nuk kanë ushtruar aktivitet në fushën e “bar-restorantit” apo të hotelerisë. Sipas deklarimeve të saj, i vetmi aktivitet i regjistruar në QKB ka qenë ai si person fizik me NIPT {***}, me aktivitet me fushë veprimtarie “avokatie”, por dhe ky pa ofruar asnjë lloj shërbimi sipas objektit të regjistruar. Subjekti ka shpjeguar se, pas lidhjes së marrëdhënies së punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, në datën 02.02.2009, dhe duke qenë ende në periudhën 3-mujore të provës, në kushtet e pasigurisë për vijimin e kësaj marrëdhënieje, ka lidhur kontratën e kredisë nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 30.04.2009, me fondin “Besa”. Sipas deklarimeve të saj, kredia, ndonëse e marrë me afat më të gjatë, nuk është përdorur sipas destinacionit të parashikuar, për rrjedhojë, është mbyllur në datën 19.05.2011, brenda një afati dyvjeçar. Subjekti ka deklaruar se burimi i shlyerjes së kësaj kredie ka qenë vetë shuma e përfituar prej saj, si dhe kursimet e krijuara nga paga.

(ii) *Lidhur me kredinë e marrë në datën 09.04.2013*, subjekti ka shpjeguar se huamarrja ka qenë në përputhje me qëllimin e lëvrimin të saj, duke e lidhur atë me investimin në pasurinë e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Sipas shpjegimeve të saj, shlyerja e kësaj kredie është kryer nga familjarët, ku një pjesë e detyrimit është përmbushur nga të ardhurat e siguruar prej qirave dhe aktivitetit tregtar të ushtruar nga vëllezërit dhe nëna e saj, përfshirë biznesin e llojit “bar-kafe”. Subjekti ka theksuar se, megjithëse ambientet janë përdorur për këto aktivitete dhe janë gjeneruar të ardhura nga qiradhënia, ajo personalisht nuk ka përfituar asnjë burim financiar prej tyre.

(iii) *Lidhur me kredinë e marrë në datën 25.09.2019*, subjekti ka shpjeguar se ajo është marrë në kushtet kur familja e vëllait të saj ndodhej në pamundësi për të shlyer një kredi të marrë nga ai, në vitin 2015, për të cilën ishte vendosur si kolateral apartamenti nr. {***}, me sipërfaqe 138.4 m², i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Si pasojë e mospërmbushjes së detyrimit, apartamenti i ishte nënshtruar procedurave të ankandit nga Alpha Bank ShA. Sipas subjektit, në mungesë të një pasurie të paluajtshme në emrin e saj, ajo ka vendosur ta blejë vetë këtë apartament, për të cilin ka lidhur kontratën e kredisë pranë fondit “Besa”, në vlerën 50.000 euro. Subjekti ka theksuar se nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitet në fushën e hotelerisë dhe nuk ka qenë e vetëpunësuar në biznes familjar.

13.24. Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, pasi duket se:

- *Sa i takon kredive: (i) subjekti, në mënyrë të përsëritur, ka marrë kredi për investime në aktivitete private, të cilat nuk rezultojnë të jenë ushtruar prej saj apo familjarëve të saj; (ii) deklaratimet e subjektit në formularët e marrjes së kredive bien në kundërshtim me deklaratime të kryera gjatë hetimit*

administrativ dhe fakte dhe rrethana të vërtetuara gjatë këtij hetimi; (iii) nuk vërtetohet destinacioni dhe përdorimi i shumave të përfituara nga kreditë e tërhequra nga subjekti i rivlerësimit; (iv) nuk vërtetohen deklaratimet e subjektit, se shlyerja e kredive prej saj (në disa raste, përpara afatit të parashikuar në kontratë), është me të ardhura të vëllezërve të saj.

- Në lidhje me ushtrimin e aktivitetit privat gjatë periudhës që ka qenë ndihmëse ligjore, që nga viti 2016 e në vijim, subjekti ka qenë e regjistruar si person fizik “avokate”, në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, veprimtari që, pavarësisht se nuk e ka ushtruar, e ka përdorur si mjet për marrjen e kredive të biznesit, në mënyrë të përsëritur.

13.25. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] E pranoj me modesti faktin se mund të kem ndryshuar destinacionin e kredisë, por ky fakt nuk mund të prevalojë mbi nevojën time familjare dhe njerëzore. Mbi të gjitha, ky veprim i imi nuk ka cenuar interesa apo të sjellë dëme. Në lidhje me gjetjen se të gjitha pagesat janë bërë cash nga vetë subjekti, sqaroj se, për sa kohë kredia ishte në emrin tim, edhe shlyerjen e kredisë do e bëja po unë nga ana formale, duke përdorur të ardhurat e vëllezërve të mi. [...]”. Në vijim, subjekti ka deklaruar se nuk ka qenë anëtare e Dhomës së Avokatisë së Republikës të Shqipërisë, nuk ka aderuar dhe nuk ka paguar kuotizacionin vjetor pranë kësaj dhome, për rrjedhojë, nuk ka pasur të drejtë të ushtrijë profesionin e avokatit, si dhe nuk është pajisur asnjëherë me leje vjetore për ushtrimin e këtij profesioni. Për të provuar përpjekjet nga ana saj për çregjistrimin e aktivitetit, subjekti ka depozituar një shkresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Tiranë, drejtuar QKR-së,²¹ datë 05.10.2009, e cila informon këtë të fundit për subjektet që kanë aplikuar për çregjistrim. Po ashtu, duke iu referuar parashikimeve të nenit 1 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005²², “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, subjekti ka shpjeguar se funksioni i saj si ndihmëse ligjore nuk lidhet me vendimmarrjen, për rrjedhojë, nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nuk ka kryer veprime që cenojnë etikën profesionale.

13.26. Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës lidhur me gjetjet mbi kreditë dhe se deklaratimet e subjektit në parashtrime, në përpjekje për të justifikuar ligjshmërinë e dhënies së kredisë së marrë, janë të pabazuara, përderisa është vërtetuar që kredia që subjekti i referohet është dhënë për aktivitetin si “avokate” dhe me destinacion investime në biznesin “bar-kafe”, ndërkohë që as subjekti dhe as vëllezërit e saj nuk kanë ushtruar aktivitet biznesi të çdo lloji. Po kështu, edhe në rastet e tjera, është vërtetuar se janë dhënë kredi biznesi bazuar në ushtrimin e aktivitetit privat të subjektit të rivlerësimit si avokate, si dhe në një rast për ushtrimin e aktivitetit të “hotelerisë”, ndërkohë që as subjekti dhe as vëllezërit e saj nuk e kanë ushtruar një aktivitet të tillë në kohën e marrjes së kredive. Po kështu, u vërtetua që në aktet e përpiluara nga nëpunësit e kredisë dhe në formularët e deklaratimit të subjektit pasqyrohen fakte dhe rrethana që janë të pavërteta. Në lidhje me

²¹ Akronim i “Qendra Kombëtare e Regjistrimit”.

²² Neni 1- “Qëllimi i këtij ligji është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta”.

regjistrimin e aktivitetit privat si “avokate”, gjatë periudhës që subjekti ka qenë ndihmëse ligjore, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka vijuar të ndjekë procedurat për mbylljen e tij, pas kërkesës së vitit 2009, por përkundrazi e ka përdorur aktivitetin në mënyrë të përsëritur për marrjen e disa kredive, duke krijuar bindjen se mosveprimet e subjektit për mosçregjistrimin e aktivitetit kanë pasur si qëllim marrjen e kredive.

13.26.1. Sa i takon konfliktit të interesit, Komisioni ka vlerësuar se, për sa kohë subjekti nuk ka pasur funksion vendimmarrës dhe në kushtet kur është vërtetuar se nuk e ka ushtruar aktivitetin si “avokate”, mosveprimet e saj për të mbyllur këtë aktivitet, gjatë periudhës që ka qenë ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (2016 – 2020), nuk u vlerësuan me ndonjë pasojë në kuptim të konfliktit të interesit.

13.27. Trupi gjykues i Kolegjit, për sa rezultuar më sipër, në vlerësim të tërësisë së provave dhe shpjegimeve të administruara, çmon se për të gjitha kreditë e marra nga subjekti rezulton mospërputhje e vazhdueshme ndërmjet qëllimit të deklaruar nga ana saj, në formularët e plotësuar në momentin e kredimarrjes, dhe destinacionit të përdorimit të tyre, e shoqëruar kjo dhe me mungesë dokumentacioni provues, në drejtim të justifikimit të marrjes, përdorimit dhe burimit të shlyerjes të tyre. Konkretisht, për kredinë e vitit 2009, subjekti ka pranuar se ajo nuk është përdorur sipas destinacionit të deklaruar në kontratën e kredisë dhe se është shlyer brenda një afati të shkurtër, me vetë shumën e përfituar dhe kursimet nga paga, çka lë të paqartë qëllimin real të marrjes së saj. Për kredinë e vitit 2013, ndonëse subjekti ka pretenduar se ajo është përdorur për investim në pasurinë familjare në rrugën “{***}”, shlyerja është atribuar familjarëve dhe të ardhurave të tyre, pa u paraqitur prova të mjaftueshme mbi burimin, masën dhe destinacionin e këtyre të ardhurave. Po kështu, për kredinë e vitit 2019, shpjegimet e subjektit kanë rezultuar në kundërshtim me deklaratimet fillestare mbi qëllimin e saj, duke u pretenduar më pas se ajo është marrë për blerjen e një apartamenti të nxjerrë në ankand dhe jo për investime në hoteleri.

13.28. Për sa rezultuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim të procedurave të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për përfitimin e kredive në fondin “Besa”, konstaton se mbetet e provuar gjatë hetimit administrativ, si dhe e pranuar nga vetë subjekti, se të dhënat e deklaruara dhe të nënshkruara në aktet e praktikës së kredive, nuk i përgjigjen situatës reale dhe faktike të deklaruar në to, dhe duket se janë paraqitur si të tilla nga subjekti vetëm me qëllim përfitimin e kredive. Subjekti ka qenë kontradiktore dhe e paqartë sa i përket marrjes dhe shlyerjes së tyre, pasi: (i) gjatë hetimit administrativ ka ndryshuar deklaratimet mbi destinacionin e kredisë, nga kredi me qëllim financimin e investimeve për biznes, në kredi të marrë me qëllim investime në godinën pesëkatëshe; (ii) në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për investime në aktivitete private, të cilat nuk rezultojnë të jenë ushtruar nga ajo apo familjarët e saj; (iii) mbeten në nivel deklarativ, pretendimet e subjektit se shlyerja e disa kredive është realizuar me të ardhurat e vëllezërve të saj, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion, që vërteton punësimin apo të ardhura të ligjshme të tyre, në Shqipëri apo në Itali, duke mos qartësuar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e këtyre kredive, të cilat, për më tepër, nuk i ka kanalizuar nëpërmjet sistemit bankar, por ka zgjedhur t’i shlyej ato në *cash*.

13.29. Subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përsëritur, ka zgjedhur të japë përgjigje të paplota dhe jo shteruese, duke ndryshuar e shtuar elemente dhe fakte të reja, në varësi të çështjeve të ngritura nga Komisioni, duke pamundësuar arritjen e një vlerësimi objektiv mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, për secilin prej elementeve të mësipërme dhe, në pamundësi për të konkluduar me siguri mbi qëllimin, destinimin dhe burimet e shlyerjes së këtyre kredive, situata që duhen vlerësuar edhe në drejtim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

13.30. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo qasje e subjektit mbetet e njëjtë dhe sa i takon kontratës së premtim-shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.05.2011, të lidhur mes subjektit dhe nënës së saj, D. T., për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 72.5 m², të ndodhur në adresën “{***}”, Tiranë, kundrejt vlerës 7.000.000 lekë, e cila ka shërbyer për të përfutur financimin me kredi, në shumën 4.600.000 lekë, në datën 10.05.2011, apartament i cili, si përfundim, nuk u ble nga subjekti, trajtuar kjo gjerësisht në vendimin e Komisionit. Në përfundim të hetimit administrativ, edhe në këtë rast, mbeti në nivel deklarativ: (i) pretendimi i subjektit që kjo kredi, më pas, është shlyer *cash*, me shumën prej 4.600.000 lekësh, të siguruar nga nëna e saj, përmes kontratës së kaparit, datë 05.03.2014, lidhur me qëllim shitjen e së njëjtës pasuri, të ndodhur në “{***}”, për sa kohë kjo shumë nuk ka kaluar përmes llogarisë së noteres, si dhe (ii) destinacioni i kredisë, në kushtet kur pasuria objekt i kontratës së premtim-shitjes, nuk u ble nga subjekti i rivlerësimit.

13.31. Po ashtu, në drejtim të kësaj qasje të subjektit, trupi gjykues vlerëson se duhet konsideruar dhe neglizhenca e treguar nga ajo në drejtim të çregjistrimit të aktivitetit të “avokatisë”, të cilën subjekti, pavarësisht se nuk e ka ushtruar, e ka deklaruar si të tillë, për sigurimin e kredive në fondin “Besa”.

B/4 Lidhur me vlerësimin përfundimtar të çështjes

14. Në përmbledhje të sa rezultuar më sipër gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka çmuar se: “[...] për sa i përket kualifikimit ligjor të fakteve objekt hetimi, pasqyruar hollësisht në këtë vendim, shqyrtimi dhe vlerësimi për subjektin Majlinda Tosku është bërë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, duke vlerësuar përfundimisht se sjelljet e znj. Majlinda Tosku/veprimet dhe mosveprimet e saj, si përpara plotësimit të deklaratës vetting, ashtu edhe gjatë procesit të rivlerësimit, bien ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet prej subjekteve të rivlerësimit, si pjesë përbërëse e Sistemit të Drejtësisë, të cilët, edhe jashtë orarit të punës, duhet të kujdesen që sjellja e tyre të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtrojnë dhe të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji, sikurse ka ndodhur në rastin e subjektit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në obligim të nenit 43, pika 3, dhe nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka vënë në dispozicion dokumente shkresore për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, në lidhje me të gjitha kreditë e marra dhe të shlyera prej saj, dhe jo vetëm, si dhe në përpjekje për të justifikuar veprimet/mosveprimet e saj ka kryer, në mënyrë të përsëritur, deklarime kontradiktore, duke vështirësuar punën e Komisionit. [...] Në këto kushte, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka cenuar besimin e publikut në Sistemin e Drejtësisë në mënyrë të përsëritur e vijuese, duke bërë që të ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Po kështu, subjekti me sjelljen e saj gjatë procesit të rivlerësimit, ndodhet edhe në rrethanat e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, çka lidhet me mungesën e gatishmërisë për bashkëpunim, duke mos përmbushur detyrimet e saj ligjore në këtë proces,

të lidhur me nenin 43/3 të ligjit nr. 84/2016. Këto rrethana e çojnë subjektin në përcaktimet edhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Kjo është fryma që përcjell edhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në një numër të konsiderueshëm rastesh, kur ka konkluduar në lidhje me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.

14.1. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit dhe në parashtrime, kundërshton në thelb përfundimet e arritura nga Komisioni në vendimin nr. 737, datë 13.02.2024, duke iu referuar veçanërisht arsytimit dhe qëndrimit të pakicës në këtë vendim. Në mënyrë narrative, subjekti parashtron se konkluzioni i Komisionit mbi cenimin e etikës dhe të integritetit nuk mbështetet në prova konkrete apo indicie, që të vënë në dyshim figurën dhe profesionalizmin e saj, si ndihmëse ligjore. Ajo ngre pikëpyetje mbi vetë bazën e këtij vlerësimi, duke theksuar se nuk ushtron funksion vendimmarrës dhe se, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si person që “jep drejtësi” në kuptimin e magjistratit. Në vijim, subjekti pretendon se vetë Komisioni e ka pranuar mungesën e një kuadri të qartë ligjor për vlerësimin e saj si jomagjistrate, si dhe faktin që çështje të tilla, si etika dhe integriteti, kërkojnë një analizë të gjerë dhe të plotë të një sërë faktorësh. Sipas saj, Komisioni nuk e ka hetuar në mënyrë të plotë veprimtarinë e saj si ndihmëse ligjore, duke lënë jashtë vlerësimit elemente dhe indikatorë të rëndësishëm për matjen e integritetit dhe të sjelljes profesionale. Mbi këtë bazë, subjekti pretendon se vendimi për shkarkim është mbështetur në një arsytim të përgjithshëm, abstrakt dhe sipërfaqësor, në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe ligjore të procesit të rregullt, si dhe me frymën e reformës në drejtësi. Sipas subjektit, nëse Komisioni do të kishte zbatuar në mënyrë objektive dhe të plotë standardet e procesit të rivlerësimit, do të kishte arritur në përfundimin e konfirmimit të saj në detyrë.

14.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe shqyrtoi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, për këtë çështje, vlerëson se gjetjet dhe problematikat e konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit të znj. Majlinda Tosku lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e vlerësimit të pasurisë në këtë proces, si në aspektin e saktësisë dhe të mjaftueshmërisë së deklaratimit të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në raport me sjelljen procedurale të saj, gjatë hetimit administrativ në Komision, për sa në vijim.

14.3. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, në kuadër të detyrimit kushtetues, që buron nga dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe, në mënyrë të veçantë, nga neni D i Aneksit të saj, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, është i detyruar të kryejë deklarime të sakta, të vërteta dhe sa më shteruese lidhur me pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij dhe të personave të lidhur. Ky detyrim synon të mundësojë ushtrimin efektiv të kontrollit nga institucionet e rivlerësimit, nëpërmjet verifikimit të plotë dhe të besueshëm të situatës faktike të pasurisë, si dhe të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të saj. Deklarimi i subjekteve, në deklaratën e pasurisë *vetting*, shërben si baza nga ku fillon procedura e verifikimit dhe e kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit. Mosrespektimi i këtij detyrimi përbën mospërbushje të standardeve kushtetuese dhe reflekton një deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në funksion të kriterit të vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, dokumentacionit të administruar në dosje të Komisionit, shpjegimeve kontradiktore dhe joshteruese të dhëna nga subjekti, në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarinimin e saj të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “a”, dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër është evidentuar: (i) mosjustifikimi i gjendjes *cash*, të deklaruar në shumën 1.500.000 lekë, për të cilën subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota, si dhe nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësinë financiare për ta krijuar atë; (ii) mosdeklarimi dhe fshehja e përdorimit/posedimit të apartamentit në godinën 5-katëshe, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë; (iii) mungesa e provave bindëse në drejtim të shpjegimit të burimeve financiare të krijimit apo investimit në këtë pasuri; (iv) mungesa e deklaratimit të të ardhurave nga qiraja, të kaluara në llogarinë bankare të subjektit, duke mbajtur në konsideratë këtu konfuzionin e shkaktuar lidhur me ambientet e lëshuara me qira dhe mungesën e dokumentimit të destinimit të tyre.

14.4. *Së dyti*, në lidhje me kreditë e marra, veçanërisht ato pranë fondit “Besa”, trupi gjykues vëren se subjekti ka kryer deklaratime kontradiktore, nuk arriti të ishte bindëse, duke dhënë shpjegime jo të arsyeshme në drejtim të rrethanave të konstatuara. Deklarimet e bëra nga subjekti në formularët e kredimarrjes, nuk përputhen me shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me ato të paraqitura në ankimin përpara Kolegjit. Në disa raste, kreditë janë deklaruar si të destinuar për investime në aktivitete avokatie, biznesi, hoteleri apo blerje pasurie, ndërsa më pas është pretenduar se nuk janë përdorur sipas destinacionit dhe janë shlyer *cash* nga subjekti, me të ardhura të pretenduara të familjarëve apo me burim vetë kreditë e marra. Këto shpjegime të subjektit, gjatë gjithë hetimit administrativ, mbetën në nivel deklarativ dhe nuk gjetën mbështetje në prova shpresore, që të mundësonin verifikimin e qëllimit të marrjes, burimit të shlyerjes apo përdorimit real të fondeve.

14.5. *Së treti*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson me rëndësi të veçantë në këtë proces, sjelljen procedurale të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Nga analizimi i vendimit të Komisionit dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se subjekti, në fund të këtij procesi, nuk ka qenë koherente në deklaratimet e saj, si dhe i ka ndryshuar ato vazhdimisht, duke iu shmangur, në mënyrë të përsëritur, dhënies së përgjigjeve në lidhje me disa nga konstatimet e Komisionit, duke treguar në këtë drejtim një mungesë bashkëpunimi, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

14.6. Në përfundim, duke analizuar konkluzionet e mësipërme të lidhura me mosdeklarimin e përdorimit të apartamentit në godinën 5-katëshe, të ardhurat nga marrëdhënia e qirasë, problematikat e pasqyruara në raport me kreditë e marra, si dhe balancën negative të konstatuar në vlerën 600.000 lekë, në këndvështrim të qasjes së subjektit, në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar, në konsideratë të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, u vlerësuan për trupin gjykues si të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet e besueshme në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht pozicionit të saj të punës si ndihmëse ligjore.

14.7. Në këto kushte, në zbatim të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues bëri një kualifikim të ndryshëm të situatës faktike dhe konkludoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 737, datë 13.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 05.03.2026, në Tiranë.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam dakord me vendimin nr. 25, datë 05.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Tosku, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 737, datë 13.02.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur dhe konkluzionit të arritur lidhur me fshehjen/mosdeklarimin e përdorimit të apartamentit në godinën 5-katëshe, në pronësi të nënës së subjektit të rivlerësimit.
2. Trupi gjykues, lidhur me fshehjen/mosdeklarimin e përdorimit të banesës 5-katëshe, ka konkluduar se:
13.14.3. Nga analizimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve dhe rezultateve të hetimit, rezulton se ato kanë qenë të paplota, joshteruese dhe të pashoqëruara me dokumentacion provues, duke dhënë kështu një tablo të paqartë, me të dhëna kontradiktore rreth elementeve të mësipërme, situatë e cila u vlerësua nga trupi gjykues në kontekstin e kriterit të vlerësimit të pasurisë.
13.14.4. Në përfundim të sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të përdorimit të pasurisë, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklarime të pasakta lidhur me marrëdhënien e qirasë për objektin në fjalë, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja "a" e këtij ligji.
3. Unë i bashkohem vlerësimit që trupi gjykues i ka bërë fakteve dhe rrethanave që janë konstatuar nga hetimi administrativ e që kanë të bëjnë me të dhënat kontradiktore, të paqarta dhe të paplota, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision lidhur me përdorimin e apartamentit në godinën 5-katëshe, të ndodhur në rrugën "{***}", Tiranë, dhe mosdeklarimit në deklaratën *vetting*, e cila rezulton të jetë në pronësi të nënës së saj.
4. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, si dhe nga vendimi i Komisionit, kam vlerësuar se, pavarësisht konstatimeve të mësipërme, si dhe rrethanave faktike të analizuara, ato nuk mund të kualifikohen si fshehje dhe mosdeklarim i përdorimit/posedimit të apartamentit në godinën 5-katëshe, e cila nga hetimi ka rezultuar qartësisht dhe është provuar pronësia e nënës së subjektit të rivlerësimit.
5. Nga hetimi administrativ në Komision, si dhe gjatë shqyrtimit të ankimit në Kolegj është pranuar që subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar si adresë të gjendjes civile dhe si adresë vendbanimi: "*Njësia nr. {***}, apartamenti nr. {***}, në katin e dytë të godinës 5 kate, në rrugën "{***}", Tiranë*, por nuk ka deklaruar pronësinë/përdorimin/posedimin e kësaj pasurie të paluajtshme, për shkak se ajo ka banuar në shtëpinë e nënës së saj, për të cilën nuk ka paguar ndonjëherë qira. Po ashtu, subjekti, në pyetësorin standard, pa filluar ende hetimi, ka dhënë shpjegime më të plota e të qarta, duke deklaruar *se ka në përdorim një pjesë të apartamentit (68,4 m²) në pronësi të nënës së saj, znj. D. T., në posedim të të cilit ka qenë që nga viti 2012 dhe aktualisht*. Subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë, datë 19.09.2019, për pasurinë me nr. {***}, me sipërfaqe 138.4 m² në emër të nënës së saj, D. T.
6. Lidhur me kalimin e një pjese të shumave mujore të qirave të apartamenteve në pronësi të nënës, në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, referuar kontratave respektive të qirave, ku nëna e subjektit rezulton në cilësinë e qiradhënëses, gjatë periudhës 2009 – 2021, edhe pse subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime që

nga Komisioni dhe trupi gjykues janë vlerësuar deklarative e që mund të ngrenë dyshimin për “mënyrën” e përdorimit të banesës, sërisht prej tyre nuk është arritur që të argumentohet se subjekti i ka përdorur shumat monetare për interesin e saj për të krijuar ndonjë pasuri. Parë në këtë këndvështrim, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që subjekti nuk ka dhënë asnjë kontribut në ndërtimin e godinës 5-katëshe, si dhe nuk ka qenë subjekt rivlerësimi në kohën kur është ndërtuar godina, situata e mësipërme e veprimeve që ajo ka kryer me qiratë, në vlerësimin tim, nuk duhet të rëndojë pozitën e subjektit në procesin e rivlerësimit.

- 6.1. Të njëjtin qëndrim ndaj edhe sa i përket dyshimit për ekzistencën e kontratës së energjisë elektrike, të lidhur fillimisht në emër të subjektit në vitin 2006 dhe të ndryshuar në vitin 2015, në emër të nënës D. T. Në vlerësim të kësaj rrethane, që për Komisionin dhe trupin gjykues përbën veprim të dyshimtë, mbaj në konsideratë se, në gjithë këtë periudhë, subjekti nuk ka qenë në ushtrim të detyrës me statusin e subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka qenë i nevojshëm kujdesi për kryerjen e këtyre veprimeve. Nga ana tjetër, ndryshimi i emrit rezultoi të jetë bërë në vitin 2015, vit në të cilin nuk ishte miratuar ende legjislacioni për rivlerësimin dhe për subjektin është jashtë periudhës së saj të rivlerësimit.
7. Mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i përdorimit/posedimit nga subjekti i rivlerësimit të banesës ku ka jetuar me nënën e saj, në kushtet kur përdorimi ka qenë pa një akt juridik, për shkak të marrëdhënies së posaçme, mbajtur në konsideratë edhe veprimet e kryera prej saj për të suportuar personin e lidhur (nënen e saj), nëpërmjet tërheqjeve *cash* të qirave të derdhura në llogarinë e saj bankare dhe të deklaruara si të ardhura që i përkasin prindërve dhe dhënë atyre për përballimin e jetesës dhe problemeve shëndetësore, edhe pse kjo nuk provohet, referuar edhe trajtimit në paragrafët e mësipërm, në vlerësimin tim, nuk përmbushin elementet e fshehjes, në kuptim të fshehjes së pasurisë.
8. Përdorimi faktik nga ana e subjektit i pasurisë së paluajtshme me nr. {***}, si e vetmja pasuri në emër dhe pronësi të prindërve, deklaruar gjatë hetimit se është ndërtuar nga prindërit me kontributin e vëllezërve, në mungesë të një titulli juridik, që krijon të drejtë reale ose personale përdorimi në favor të subjektit, nuk mjafton për të konkluduar mbi ekzistencën e një interesi pasuror me detyrim për deklarim në funksion të procesit të rivlerësimit. Vlerësoj se fakti i përdorimit/posedimit (familjar në rastin konkret), nuk mund të barazohet automatikisht me ushtrimin e atributit të pronësisë ose me ekzistencën e një të drejte pasurore të konsoliduar mbi sendin. Nga ana tjetër, Komisioni dhe trupi gjykues nuk mundën të arrijnë në konkluzionin se subjekti ka përfutur personalisht të ardhurat nga qiratë, ka kryer ndonjë investim, ka vendosur barrë financiare, disponim apo përfitim ekonomik real nga pasuria në fjalë. Në këto kushte, mosdeklarimi i përdorimit të saj nuk mund të konsiderohet, në vetvete, si fshehje pasurie apo deklarim i pamjaftueshëm.
9. Nga kontrolli në Kolegj rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, e ka deklaruar në mënyrë të saktë adresën e saj të banimit, duke bërë transparent faktin e vendqëndrimit dhe duke mos krijuar asnjë pengesë për verifikimin e kësaj rrethane nga organet e rivlerësimit, si dhe duke përjashtuar çdo qëllim për të fshehur përdorimin e pasurisë. Nga aktet e administruara rezultoi e provuar se pasuria në fjalë është regjistruar në pronësi të nënës së subjektit që në vitin 2011²³ dhe nuk ekziston asnjë titull juridik apo element faktik, që të dëshmojë ushtrimin e një të drejte pronësore apo të një interesi pasuror

²³ Më pas në vite janë kryer veprime të tjera me pasurinë “godinë 5-katëshe”, sikurse detajuar në vendim.

të fshehur nga ana e subjektit. Në këto kushte, mungesa e deklarimit të përdorimit të kësaj pasurie nuk mund të kualifikohet si fshehje, për sa kohë që nuk provohet ekzistenca e një përfitimi ekonomik, e një interesi pasuror të maskuar apo e një ndikimi konkret në analizën financiare. Përkundrazi, përdorimi i një banese në kuadër të marrëdhënieve familjare, pa kundërshtim dhe pa pasoja ekonomike për subjektin, nuk përbën një element që cenon transparencën e deklarimit në kuptimin material të tij.

10. Ngarkimi i subjektit me pasojën e shkarkimit nga detyra për shkak të mosdeklarimit/fshehjes së përdorimit/posedimit të banesës, në të cilën ka jetuar me prindërit, çon në një interpretim të zgjeruar të detyrimit për deklarim, deri në përfshirjen e çdo forme përdorimi familjar të pasurive të personave të lidhur. Kjo do të sillte si pasojë cenimin e standardit të proporcionalitetit dhe sigurisë juridike, pasi do të barazonte marrëdhëniet familjare të posaçme me ekzistencën e çdo të drejte pasurore. Në rastin konkret vlerësoj se, edhe nëse do të konsiderohej një pasaktësi formale, ajo mbetet e paqëllimshme dhe nuk arrin nivelin e një deklarimi të pamjaftueshëm apo të pasaktë, që të justifikojë pasojën maksimale disiplinore.
11. Konkluzioni i arritur nga shumica e trupit gjykues për këtë pasuri vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme,²⁴ për kualifikimin e mosdeklarimit të përdorimit të banesës që është e regjistruar në emër të prindërve dhe që rëndon padrejtësisht subjektin, e cila deklarimin e parë të interesave privatë e ka bërë vetëm në vitin 2016, kur ka marrë edhe statusin e subjektit të rivlerësimit.
12. Në përfundim të analizës së mësipërme, si dhe duke konfirmuar qëndrimin tim të mëparshëm²⁵ lidhur me deklarimin e përdorimit të banesës, në kushtet e një jetese të përbashkët të subjektit me personat e lidhur/prindërit, vlerësoj se mosdeklarimi i përdorimit të pasurisë nuk mund të kualifikohet si fshehje e qëllimshme e elementeve pasurore, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, por mund të jetë një pasaktësi formale në deklarim, pa pasojë për shkarkim.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

²⁴ Vendimi i KPA-së me nr. 29/2024 (JR), datë 27.06.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit N. T., paragrafët 26.3/dh – 26.3/f. Në këtë vendim, trupi gjykues, edhe pse ka shprehur qëndrimin që subjekti kishte detyrim të deklaronte banesën në përdorim dhe jo vetëm adresën e vendbanimit, në përfundim nuk e ka kualifikuar si fshehje e përdorimit të banesës.

²⁵ Shih mendimin paralel në vendimin e KPA-së nr. 48/2022 (JR), datë 15.12.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit E. T. dhe mendimin e pakicës në vendimin e cituar në poshtëshënimin e mësipërm.